



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.04.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Ceremonia e betimit të gjyqtarit {...} i cili ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021 - 2022, i emëruar më datë 06.03.2023.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu** (anëtare)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**
- 4. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
- 7. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 9. Edmon Hoxhaj, (Birn).**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Ceremonia e betimit të gjyqtarit {...} i cili ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021 - 2022, i emëruar më datë 06.03.2023.

**Naureda Llagami:** Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni sot kemi katër çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit.

Po fillojmë me çështjen e parë e cila ka të bëjë me ceremoninë e betimit të gjyqtarit {...} i cili ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021 - 2022, i emëruar më datë 06.03.2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë Pukë.

*(Ftohet të hyjë në sallën e mbledhjes z. {...}. Hyn në sallën e mbledhjes z. {...}.)*

Përshëndetje zoti {...}!

Atëherë, sot, siç jeni njoftuar, zhvillohet ceremonia e betimit. Në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 37 parashikohet që magjistrati para fillimit të ushtrimit të funksionit bën betimin.

Lidhur me tekstin e betimit, jua kemi vënë në dispozicion aty.

Njëren dorë do e mbështesni tek Kushtetuta dhe do lexoni tekstin e betimit.

Z. {...} lexon formulën e betimit si më poshtë:

{...}: “Beto hem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale. Beto hem!”

*Naureda Llagami*: Faleminderit dhe suksese në detyrën tuaj!

{...}: Faleminderit juve!

Punë të mbarë!

*(Del nga salla e mbledhjes magjistrati z. {...}.)*

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.04.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarës {...}, për vitin 2021, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale relatores znj. Irena Plaku.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13:30.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**
- 4. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
- 7. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 9. Edmon Hoxhaj, (Birn).**

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtares {...}, për vitin 2021, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale relatore znj. Irena Plaku.

Pas trajtimit të çështjes së trajtuar vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit, vijon mbledhja me çështjen e tretë të rendit të ditës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tashmë tek çështja tjetër e rendit të ditës.

Siç jeni në dijeni, sipas rendit kemi vlerësimin etik dhe profesional, për gjyqtaren {...}, për vitin 2021. Për më shumë detaje, ftoj relatoren znj. Irena Plaku për të relatuar projektraportin.

***Irena Plaku***: Faleminderit Kryetare!

Atëherë, sot po parashtrojmë projektaportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2021.

Procedura e vlerësimit etik dhe profesional e përshpejtuar për gjyqtaren {...} ka filluar me vendimin nr. 146, datë 13.01.2022... më fal. Ka filluar për shkak të aplikimit të saj për ngritjen në detyrë. Është zhvilluar procedura përkatëse. Janë tërhequr aktet. Është bërë procedura e shortit. Është njoftuar gjyqtarja rregullisht. Janë dërguar aktet nga gjykata, gjithashtu edhe nga institucionet e tjera, dhe nga ILDKPI-ja.

Atëherë po kaloj tek kriteri i parë. Analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe përcaktimi i nivelit të vlerësimit për çdo kriter vlerësimi.

Konkretisht për sa i përket “Aftësisë profesionale të gjyqtarës”, “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes...”, referuar burimeve të vlerësimit pasqyruar në raportin analitik rezulton se gjyqtarja parashtron në mënyrë të detajuar faktet e çështjes, në një pjesë të veçantë dhe të dallueshme të pjesës përshkruese-arsyetuese të titulluar “Rrethanat e çështjes”. Faktet gjenden të pasqyruara edhe në pjesën e pretendimeve përkatëse të palëve, të cilat janë të përshkruara në mënyrë të mëvetësishme në pjesë të veçanta të vendimit. Gjithashtu evidentohet se faktet gjenden edhe te nënndarja e vlerësimit ligjor të gjykatës mbi bazueshmërinë në ligj dhe në prova të pretendimeve.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjeve, në vendimet e analizuara, evidentohet se gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve. Identifikon natyrën administrative të çështjes objekt gjykimi, duke specifikuar se me çfarë lidhet mosmarëveshja objekt gjykimi.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Në projektraport janë cituar të gjithë dispozitat ligjore të cilat janë konstatuar nga vendimet gjyqësore burim vlerësimi, që janë gjashtë vendimet e zgjedhura me short dhe dy vendimet e zgjedhura nga gjyqtarja.

Sa i përket aspektit të vendimit të konfliktit të normës, në vendimet e analizuara nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural. Vetë gjyqtarja e ka vlerësuar në formularin e vetëvlerësimit se ka vlerësuar aftësinë e saj shumë të lartë.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin dhe analizën e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor. Gjithashtu, gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes...” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

“Aftësia për të interpretuar ligjin ...”

Në interpretimin e ligjit material dhe procedural të zbatueshëm - Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështje. Në çdo rast citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave

materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin në lidhje me shkaqet e ankimit apo për t'i dhënë përgjigje pretendimeve të palëve në rastet kur ato kanë qasje tjetër ndaj qëllimit të ligjit.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm, evidentohet se interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës. Interpretimi i normës lidhet gjithmonë me faktet e provuara.

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale, konstatohet se gjyqtarja ka përdorur gjerësisht edhe interpretimin e dispozitave procedurale, duke cituar dispozitat konkrete të cilat janë cituar në vendimet gjyqësore burim vlerësimi. Gjithashtu konstatohet se gjyqtarja përdor jurisprudencën relevante të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Administrativ dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së. Në projektraport janë referuar edhe vendimet përkatëse që i përkasin jurisprudencës por edhe vendimet përkatëse të gjykatës së apelit ku janë referuar këto vendime.

Gjithashtu në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i veçantë i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referojë dhe zbatojë parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti, konkretisht: *parimin e proporcionalitetit; parimin e shtetit të së drejtës; parimet për shkallëzimin dhe individualizimin e masave disiplinore; parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve; parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë mes palëve; parimin e ligjshmërisë, etj.*

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në



shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Për sa i përket “Arsyetimit ligjor”, “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve, primeve apo të drejtave të palëve në proces, edhe në rastet kur rezulton përdorimi i termave latinë, të cilat janë futur gjithmonë në thonjëza, kuptimi i tyre jepet edhe në gjuhën shqipe.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në vendimet evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin.

Edhe lidhur me këtë nëntregues gjyqtarja ka vlerësuar aftësinë e saj shumë të lartë.

Në tërësi referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe

kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë tek tjetra. Pjesët e vendimit fillojnë me tituj, e cila shpreh idenë të mendimit të asaj njësie ose konkluzionit mbi të cilin shtjellohet argumenti. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, por dëshmon qëndrueshmëri dhe rrjedhshmëri të paraqitjes së argumenteve.

Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Struktura e qëndrueshme e vendimit” - Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, interpretimin e tij, aplikimin mbi faktet dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Konkretisht, në përmbajtje të vendimeve evidentohet se vendimet gjyqësore përmbajnë pjesët përkatëse, konkretisht pjesën hyrëse.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues dhe sekretaren gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të gjykimit, identitetin e palëve, objektin dhe bazën ligjore të padisë, disponimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si dhe shkaqet e ankimit, duke i renditur secilën prej tyre në mënyrë logjike.

Pjesa përshkruese-arsyetuese rezulton që të jetë ndarë në mënyrë të shprehur në disa nën tituj, konkretisht “Rrethanat e çështjes”; “Vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë”; “Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit” në lidhje me çështjet. Në pjesën e parë të titulluar “Rrethanat e çështjes” paraqiten rrethanat e faktit, siç kanë rezultuar të provuara nga shqyrtimi gjyqësor në shkallë të parë, duke referuar dhe aktet provuese. Në pjesën e dytë të titulluar “Vlerësimi i gjykatës”, gjyqtarja pasqyron disponimin dhe arsyet e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë, të cilat lidhen me shkaqet e ankimit. Në pjesën e tretë të titulluar “Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit”, gjyqtarja analizon shkurtimisht në lidhje me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, kushtet e pranueshmërisë së ankimit, për të vijuar me vlerësimin

dhe arsyet e Gjykatës Administrative të Apelit se pse vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet apo të lihet në fuqi. Karakteristikë e gjyqtarës është që i jep përgjigje çdo pretendimi të palës, duke i analizuar një e nga një secilin pretendim më vete, duke i ndërthur me faktet dhe provat. Gjyqtarja referon gjithmonë në nenin 17/2 të ligjit 49/2012, në lidhje me cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Në pjesën urdhëruese të vendimit referohet baza ligjore procedurale e vendimmarrjes, si dhe disponimi për lënien në fuqi apo për prishjen e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, konform nenit 50/b ose 50/ç të ligjit nr.49/2012, për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi (në varësi të lënies në fuqi apo prishjes...), konform nenit 53/b, për çështjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore dhe konform neneve 28-30 të ligjit në rastin e shqyrtimit të kërkesës për marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë. Gjithashtu, gjen pasqyrim disponimi lidhur me të drejtën e ushtrimit të rekursit, afati i ushtrimit të kësaj të drejte, momenti kur fillon të llogaritet ky afat.

Edhe për këtë tregues gjyqtarja ka vlerësuar aftësinë e saj shumë të lartë.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëri paragraf në tjetrin dhe nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në këtë tregues vlerësohet “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 10 pikë.

Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik - Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se vendimet gjyqësore dominohen nga proces analitik dhe vlerësues në raport me atë përshkrues të fakteve dhe provave. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në

vendimet gjyqësore burim vlerësimi është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë e saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni mbi provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në vendimet burim vlerësimi, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, analiza e faktit dhe ajo ligjore, zhvillohen në mënyrë logjike, duke paraqitur argumente për secilin shkak ankimi më vete. Norma ligjore zërthehet sipas qëllimit, duke i dhënë përgjigje shkakut konkret të ngritur në padi apo në ankim, pa zgjatje dhe konfuzion, në rrjedhë logjike me konkluzionin e arritur.

Argumentet ndjekin një linjë arsyetimi e cila zhvillohet në mënyrë dinamike mbi çdo fakt apo çështje të marrë në analizë, duke mbështetur në mënyrë logjike konkluzionin e arritur. Gjyqtarja tregon kujdes të veçantë për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore të zbatueshme në çështjen konkrete, nëpërmjet një analize dhe interpretimi individual lidhur me kuptimin e tyre, duke i mbështetur më pas ato edhe me qëndrime të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë apo edhe të GJEDNJ kur është vlerësuar e nevojshme. Në mënyrë konkrete, në disa nga vendimet burim vlerësimi, ka rezultuar se gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi të posaçme analizës abstrakte të instituteve, parimeve apo normave ligjore, para aplikimit të tyre mbi faktet konkrete, konkretisht: analizimin e dëmit jashtëkontraktor për paligjshmëritë; lidhjen shkak – pasojë për barrën e provën; ka marrë në analizë për largimin nga shërbimi civil, etj.; konceptet e Lejes së Ndërtimit; kuadrin ligjor për të drejtën për përfitimin e pensionit të invaliditetit; dhe shumë koncepte të tjera të cilat janë të evidentuara në projektraportin e vlerësimit.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor. Në të gjitha çështjet e shqyrtuara, shkaqet e ankimit merren në analizë nga ana e gjyqtarës dhe ju jepet në çdo rast përgjigje e argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Gjyqtarja analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjesh, për të vijuar me analizën e koncepteve ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes, mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre mbi

rastin në shqyrtim. Gjyqtarja e zhvillon argumentimin e saj duke ndjekur logjikën e zhvillimit e marrëdhënies shkak-pasojë, si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për t'i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur të standardin e procesit të rregullt ligjor.

Pas analizës së të dhënave vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi: Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësia profesionale e gjyqtares” është 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket “Aftësisë organizative”, së pari dua të theksoj se nga ana e gjyqtares lidhur me këtë tregues janë paraqitur kundërshtime, të cilat janë bërë të ditura. Gjithashtu ka paraqitur edhe provat përkatëse. Janë më shumë se 35 dosje gjyqësore të cilat janë paraqitur në protokoll, por për shkak se janë shumë voluminoze, nuk janë fotokopjuar për të gjithë anëtarët.

Së pari, përpara se të lexoj projektraportin në lidhje me këtë kriter, dua të theksoj se nga ana ime nuk janë vlerësuar dosjet e paraqitura konkretisht dosjet e reja të paraqitura nga ana e gjyqtares për sa kohë që procedura e vlerësimit bëhet vetëm mbi dosjet e zgjedhura me short, vendimet e zgjedhura nga ana e gjyqtares dhe nuk mund të shtrihet në gjithë dosjet që i përkasin periudhës së vlerësimit sepse kjo do ta bënte të pamundur vlerësimin por edhe do humbte kuptimi i vlerësimit mbi ato rregulla të cilat ne i kemi përcaktuar. Kështu që vlerësimi është bërë vetëm mbi bazën e statistikave dhe të dhënave të cilat janë paraqitur në dosjen e vlerësimit.

Gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime sa i përket “Respektimit të afateve ligjore” duke pretenduar dhe ka arsyetuar edhe shkaqet dhe pretendon që dosjet janë gjykuar brenda afatit ligjor.

Atëherë, lidhur me “Respektimin e afateve ligjore”, nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar rreth 91 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor dhe 60 çështje me afat standard. Konkretisht për përcaktimin nëse janë në afat ligjor apo tej afatit ligjor... Më fal, me standard minimal janë marrë për bazë ashtu si në vlerësimet e mëparshme, fakti nëse çështjet janë gjykuar në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore. Çështjet të

cilat janë shqyrtuar në seancë gjyqësore janë vlerësuar me standard minimal dhe i jemi referuar standardeve të vendosura në vendimin nr.261/2, 14.04.2010 të KLD-së për gjykimet në apel, në seksionin e përgjithshëm, në kushtet kur në momentin kur ka dalë ky ligj nuk ka ekzistuar gjykata administrative.

Duke i ndarë sipas kategorive, çështjet e gjykuara tej afatit ligjor, rezultojnë si më poshtë:

59 çështje me palë kundërshtare të shqyrtuar në dhomë këshillimi, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (30 ditë) të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar. Koha e tyre varion nga 96 ditë deri në 1586 ditë (afërsisht 4 vjet) nga dita e shortit.

5 çështje nga kategoria “Çështje pa palë kundërshtare” me objekt “Sigurim padie”, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor, të parashikuar nga neni 28 i ligjit dhe vetëm 2 çështje me të njëjtin objekt kanë përfunduar brenda afatit 5-ditor. Megjithatë po të marrim në konsideratë kohën e shkurtër të kalimit të afatit 5-ditor për çështjen me nr. rendor 5, duke zbritur ditët e pushimit, tejkalimi prej 2 ditësh do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë do të konsiderohet si e përfunduar brenda afatit ligjor 5-ditor. Nga vëzhgimi i tabelës nr.4 që i përket kategorisë së çështjeve me “Juridiksion fillestar”, konstatohet se çështja me nr. rendor 7, me objekt “Sigurim padie” është çështje me afat ligjor dhe konstatohet se ajo ka përfunduar brenda 1 dite. Pra në total nga 8 çështje me objekt “Sigurim padie”, 4 çështje do të konsiderohet të përfunduar brenda afatit ligjor dhe 4 çështje të përfunduara jashtë afatit ligjor.

34 çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune” të shqyrtuara në dhomë këshillimi, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (30 ditë) të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se 7 çështje janë shqyrtuar në seancë gjyqësore dhe këto do merren tek “Standardet minimale”.

Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (88 çështje), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat ligjor (92 çështje, pasi u shtua çështja me nr. rendor 7, tabela 4), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 95 % të çështjeve me afat ligjor.

Siç e thashë, gjyqtarja ka pretenduar ndër të tjera, tek kundërshtimet e saj, se çështjet me objekt “sigurim padie” janë çështje të cilat janë paraqitur si pasojë e ankimit. Në fakt nga të dhënat statistikore nuk më ka rezultuar kjo gjë dhe për këtë arsye i jam referuar afatit 5-ditor. Gjyqtarja për këtë ka paraqitur edhe dosje, siç e thashë. Megjithatë, edhe sikur të marrim të mirëqenë këtë që këto çështje nuk janë me afat 10-ditor por 30-ditor, duke qenë se janë shqyrtuar në dhomë këshillimi, përsëri përqindja që do të dali nuk do ndryshojë pikëzimin e saj, sepse nuk shkon në një pikëzim më të lartë.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja ka paraqitur në formularin e integruar shpjegime të gjata, të cilat janë pasqyruar në projektraport, gjithashtu ka paraqitur edhe kundërshtime. Në këto kundërshtime, ndër të tjera ka referuar duke treguar arsyet dhe shkaqet të cilat kanë çuar në shlyerjen e këtyre sencave. Dua të relatoj se për llogaritjen e këtyre afateve është vlerësuar nga momenti që çështja është hedhur në short, ndërsa gjyqtarja në kundërshtimet e saj ka paraqitur nga data në të cilën ajo e ka nxjerrë për gjykim. Por ne kemi mbajtur një standard, që për të konsideruar afatin ligjor, do i referohemi çështjeve nga dita që është hedhur në short dhe më pas nga dita në të cilën është marrë vendimi, dhe jo nga dita e nxjerrjes për gjykim.

Duke marrë parasysh shpjegimet e gjyqtares si dhe aktet e paraqitura, në përlllogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, ka filluar nga dita e shortit (pra data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtares). Në të gjitha dosjet, në përlllogaritje do të zbriten: leja vjetore 35 ditë; kohën gjatë secilës gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësore, apo në pamundësi për t’u paraqitur në punë si person kontakti me Covid -19 .

Nga aktet e paraqitura dhe nga dosjet të cilat janë pasqyruar edhe raportet shëndetësore, konstatohet që gjyqtarja ka qenë për një periudhë nga fundi i janarit deri në fund të marsit, ka qenë me raporte shëndetësore (Covid, kontakt Covid-i). Më pas në muajin prill ka kryer një pjesë të lejes së zakonshme të vitit 2020. Është pasqyruar edhe fakti që ka qenë në procedurën e vetting-ut nga muaji shkurt deri në datën 26.04.2021 kur është marrë vendimi për konfirmimin e saj në detyrë.

Duke vlerësuar me kujdes çdo çështje referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe shpjegimeve të gjyqtares në lidhje me shkaqet që kanë çuar në kohëzgjatjen e gjykimeve, edhe pas zbritjes së ditëve kur gjyqtarja ka qenë në pamundësi për t’u

paraqitur në gjykatë si dhe kohën e kryerjes së lejes së zakonshme, përsëri rezultati nuk ndryshon në lidhje me shqyrtimin e tyre brenda afatit ligjor 30 ditor. Por me këtë rillogaritje shkurtohet afati i gjykimit të secilës çështje.

Ndërsa po t'i referohemi datës kur gjyqtarja ka caktuar çështjen për shqyrtim në dhomë këshillimi (pra nga dita kur çështja është nxjerrë për gjykim), duke e krahasuar me çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja ka planifikuar përgjithësisht seancën për shqyrtimin e saj brenda afatit ligjor 30-ditor dhe mosshqyrtimi brenda këtij afati përgjithësisht ka ardhur për arsye të përligjura. Kjo analizë është bërë vetë në dosjet të cilat janë në dosjen e vlerësimit, konkretisht dosjet e hedhura në short dhe është kosntatuar që nga momenti që gjyqtarja i nxjerr çështjet për rigjykim respekton gjithmonë afatin 30-ditor dhe sa herë që është shtyrë, të paktën nga dosjet e zgjedhura me short, sa herë që është shtyrë, kanë qenë shkaqe të cilat nuk është shqyrtuar brenda afatit në dhomë këshillimi për shkak të mosformimit të trupit gjykues të njërit nga anëtarëve të cilët kanë qenë gjithmonë të përligjura, referuar vetëm dosjeve të përzgjedhura me short; nuk jam referuar akteve të reja të paraqitura nga ana e gjyqtares.

Sa më sipër, në total nga 92 çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre, edhe pas rillogaritjes, rezulton që gjyqtarja ka përfunduar jashtë afatit ligjor 88 çështje ose 95 % të çështjeve që parashikojnë afat ligjor. Referuar tabelës së pikëzimit për këtë tregues, të përcaktuar në rregulloren nr.264/2019, kjo përqindje ekuivalentohen me 3 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për periudhës 1-vjeçare objekt vlerësimi 151 çështje, nga të cilat 126 çështje janë me palë kundërshtare (94 janë çështje



administrative dhe 32 marrëdhënie pune, dhe janë edhe 12 çështje që i përkasin juridiksionit fillestar).

Në lidhje me rritjen e papritur të volumit të punës si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, rezultoi se gjatë vitit 2021 gjyqtarës i janë caktuar me short si relatores 868 çështje me palë kundërshtare, të ardhura dhe si pasojë e rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të shkarkuar nga KPA dhe KPK. Gjatë vitit 2021, gjyqtarja nuk është paraqitur në punë për arsye shëndetësore si dhe për shkak të kryerjes së një pjese të lejes së zakonshme, të pakryer gjatë vitit 2020, për një periudhë gati rreth dymujore. Gjithashtu, ajo ka qenë e angazhuar me procesin e vlerësimit kalimtar. Gjithashtu, ka rezultuar se gjatë vitit 2021 në Gjykatën Administrative të Apelit janë shkarkuar 2 gjyqtarë që kanë qenë në trup gjykues me të, konkretisht në datë 25.03.2021 është pezulluar gjyqtari B.SH. dhe në datë 18.06.2021 është shkarkuar gjyqtari K.S., të cilët kanë sjellë shtyrjen e seancave të gjykimit (si ato të planifikuara në dhomë këshillimi edhe ato në seancë gjyqësore) ashtu edhe rishortimin e dosjeve të tyre dhe plotësimin e trupit gjykues me gjyqtarë të tjerë. Gjyqtarja, për të provuar këto pretendime, në provat e paraqitura së bashku e kundërshtimet ka paraqitur edhe vendimet e kryetarit apo zëvendëskryetarit të gjykatës që kanë ndryshime të herëpashershme të trupit gjykues, për shkak të këtyre ndryshimeve.

Gjithashtu, gjyqtarja është caktuar në pozicionin e zëvendëskryetares në datë 09.07.2021, pas shkarkimit nga KPK-së në datë 08.07.2021 të zëvendëskryetares Lindita Sinanaj, duke ushtruar detyrat e plota të kryetarit të gjykatës në kushtet kur më parë kryetari i kësaj gjykate ishte shkarkuar.

Konkluzion: Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Në përcaktimin e nivelit të pikëzimit konsiderohen në rastin konkret:

i) ngarkesa e gjyqtarës si relatores dhe anëtare (në total ka gjykuar 151 çështje si relatores, nga të cilat 126 janë çështje me palë kundërshtare dhe 199 çështje si anëtare, nga të cilat 27 çështje i përkasin juridiksionit fillestar);

ii) vetëvlerësimi i gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;

iii) numri i lartë i çështjeve me afat ligjor ku gjyqtarja ka qenë relatores pasi rezulton se ka përfunduar 92 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë 61 % të çështjeve të shqyrtuara prej saj në vitin 2021;

iv) si dhe duke pasur në vëmendje se caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankim të palës/palëve, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit.

v) mungesën e gjyqtarës në punë për arsye shëndetësore apo për shkak të kryerjes së një pjese të lejes së zakonshme deri në muajin qershor 2021, për një periudhë rreth 2 muaj, si dhe angazhimin e saj në procesin e rivlerësimit kalimtar;

vi) pezullimin dhe shkarkimin nga detyra e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Administrativ të cilët kanë qenë në trup gjykues me gjyqtaren, si dhe angazhimi i tyre në procesin e rivlerësimit kalimtar (kjo e dhënë në fakt është shkruar sepse në dosjet të cilat kanë qenë burim vlerësimi, 6 dosjet e përzgjedhura me short, është konstatuar që disa herë seancat që ishin në dhomë këshillimi ishin shtyrë për këto shkaqe, duke paraqitur raporte shëndetësore apo mosformimin e trupit gjykues, duke cituar edhe shkakun që njëra nga anëtarët ishte shkarkuar apo në një rast ishte në seancë plenare pranë KPK-së).

vii) pozicioni i gjyqtarës si zëvendëskryetare e Gjykatës nga data 09.07.2021, për një periudhë prej 6 muajsh gjatë vitit 2021, e cila në mungesë të kryetarit, ka ushtruar me kompetenca të plota detyrën e kryetarit të gjykatës.

Sa më sipër, referuar analizës logjike të të dhënave vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivele të ndryshëm se pikëzimi që rezulton nga të dhënat statistikore, duke u pikëzuar me 9 pikë, por kurrsesi nuk duhet të shkojë në një pikëzim maksimal.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është e lartë, brenda marzhit “11-20 %”, duke e pikëzuar me 9 pikë.

“Plotësimi i standardeve minimale kohore” - Sikurse u analizua edhe në treguesin e mësipërm, çështjet gjyqësore të shqyrtuara në seancë gjyqësore do të llogariten si çështje me standard minimal kohor. Po kështu, edhe çështjet e juridiksionit fillestar, do

të konsiderohen çështje me standard minimal kohor, në kushtet kur këto çështje gjykohen në bazë të kompetencës funksionale të gjykatës, duke e gjykuar si gjykatë e shkallës së parë.

Është bërë një analizë e burimeve të vlerësimit në këtë tregues të pasqyruar raportin analitik si dhe nga përpunimi edhe një herë i të dhënave statistikore rezulton që çështjet përgjithësisht kanë përfunduar brenda standardit minimal, duke i arsyetuar më poshtë.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (59 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 37% të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor. Sipas “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, të miratuar kjo përqindje përkon me vlerësimin me 2 pikë.

Edhe për këtë tregues, në formularin e vetëvlerësimit, gjyqtarja ka paraqitur pretendime të zgjeruara të cilat janë paraqitur në projektraport.

Lidhur me përcaktimin e aspektit sasior në vendimin nr. 261/2, të vitit 2010, të KLD, nuk rezulton të jetë përcaktuar një standard orientues në aspektin sasior për gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative në apel, por vetëm për gjyqtarin e shkallës së parë të dhomës civile, që gjykon në seksionin administrativ. Kështu, për analogji, pasur parasysh faktin se jemi përpara gjykimit në apel me natyrë administrative do t'i referohemi standardit sasior të punës së përcaktuar për gjyqtarin e apelit të dhomës civile, standard ky i mbajtur edhe për gjyqtarët e tjerë. Sipas pikës 3 shkronja “i”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës civile, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh civile.

Ndërsa në pikën 3, shkronja “k” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, të miratuar me vendimin nr.261/2, përcaktohet se: “Kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese minimale respektivisht në masën e 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit”.

Ka rezultuar se gjyqtarja është caktuar në detyrën e zëvendëskryetares në datë 09.07.2021. Pra rezulton se ajo ka ushtruar detyrën e kryetares për një periudhë gati 6-mujore, brenda periudhës së vlerësimit, çka nënkupton një ngarkesë sasiore gjatë vitit prej jo më pak se 140 çështje, duke e ulur deri në 40% për vetëm 6 muaj.

Gjyqtarja rezultoi se gjatë vitit 2021 ka përfunduar në total 151 çështje si relatores, duke e tejkaluar standardin e ngarkesës me 11 çështje.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal të çështjeve në masën 39 %, pavarësisht ngarkesës në punë, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes për përfundimin e gjykimit në 62.7 % të tyre duke respektuar standardin minimal kohor; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit që lidhen me periudhën në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar për shkak të pandemisë Covid 19; (iii) angazhimin e gjyqtares brenda periudhës së vlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar, deri në dhënien e vendimit nga KPK-ja; iv) pamundësinë e saj për t'u paraqitur në punë për arsye shëndetësore për një periudhë gati 2-mujore; (iv) angazhimin e gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës Administrative të Apelit në procesin e rivlerësimit kalimtar në periudhën 2020 - 2021; (v) rritjen e papritur të volumit të çështjes për shkak të rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të larguar nga detyra; (vi) tejkalimin e standardit sasior me vetëm 11 çështje, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel të ndryshëm nga pikëzimi nga ai që përkon me llogaritjen matematikore, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Siç e thashë edhe më sipër, për këtë nuk ka paraqitur kundërshtime por ka pretenduar se tek pjesa e treguesit sasior duhet të hiqet edhe dy muaj që ka qenë me raport shëndetësor. Në fakt unë këtë nuk e kam zbritur, duke e konsideruar vit të plotë, se për të gjithë gjyqtarët nuk kemi zbritur as muajin gusht, megjithëse tek llogaritja e standardeve, tek koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje i është zbritur të gjithë gjyqtarëve. Është marrë një viot i plotë kalendarik dhe standardi është llogaritur për vitin e plotë kalendarik.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “plotësimi i standardeve”, vlerësoj se gjyqtarja duhet të vlerësohet në nivelin 0-10%, pikëzuar me 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” - Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik si dhe nga përpunimi i detajuar i të dhënave statistikore, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar për gjysmën e kategorive të çështjeve. Konkretisht,

Në kategorinë “Çështje me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 403 ditë (1 vit e 1 muaj e 13 ditë), pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim. Ndërsa pas një rillogaritje të bërë, referuar tabelave statistikore, duke zbritur këtu për çdo çështje, në varësi të datës së nxjerrës për gjykim periudhën e kryerjes së lejes së zakonshme si dhe kohën gjatë secilës gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësore, rezulton një afat më i shkurtër, por përsëri më i gjatë se standardi minimal kohor.

Në kategorinë “Çështje pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 0.7 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muaj.

Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 299 ditë (9 muaj 25 ditë), pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim. Megjithatë, po të zbrisim nga ky afat për secilën çështje, në varësi të datës së nxjerrës për gjykim, periudhën e kryerjes së lejes së zakonshme, prej 35 ditësh kalendarike, kohën gjatë secilës gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësore përgjatë vitit 2021 (gati dy muaj), si dhe periudhën e kohës që veprimtari gjyqësor ka qenë e pezulluar gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë Covid 19, rezulton se kjo kategori çështjes ka përfunduar brenda afatit 6-mujor.

Në kategorinë e çështjeve “Juridiksion fillestar”, pas një rillogaritje të kohës që i dedikohet çdo çështje (përpunimit të statistikave), duke e llogaritur afatin nga momenti i nxjerrjes së çështjes për gjykim, rezulton se për 12 çështje për të cilat nuk parashikohet afat ligjor për shqyrtimin e tyre, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 151.4 ditë (rreth 5 muaj e 1 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar

prej 6 muajsh, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim. Në këtë afat nuk është llogaritur zbritja e kohës gjatë secilës gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësore apo periudhën gjatë secilës ka kryer lejen e zakonshme, duke qenë se ishte më e vogël se 6 muaj.

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e gjatë se standardi për gjysmën e kategoritë e çështjeve, duke u tejkeluar standardin kohor minimal i gjykimit me rreth thujse 3 muaj e 10 ditë tek gjykimet administrative me palë kundërshtarë, dhe me thujse 3 muaj në çështjet marrëdhënie pune. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 3 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, po të zbresin periudhën gjatë secilës gjyqtarja ka qenë në pamundësi për t’u paraqitur në gjykatë për arsye shëndetësore, kryerjen e lejes së zakonshme, si dhe periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të pandemisë, rezulton koha mesatare e gjykimit të këtyre çështjeve është brenda 6 muajve, duke bërë që koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje të jetë më shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve, llogaritje e cila sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 4 pikë. Por duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve, specifikat e gjykimit në apelin administrativ në lidhje me organizimin e punës për shkak se gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre dhe pesë gjyqtarë, angazhimin e saj dhe të anëtarëve të trupit gjykues gjatë këtij viti në procesin e rivlerësimit kalimtar (vetting), funksionin e gjyqtarës si zëvendëskryetare e gjykatës si dhe faktin se përgjithësisht gjyqtarja ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve, vlerësohet që niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë se ai që i korespondon pikëzimit të përcaktuar në tabelën përkatëse, duke arritur në pikëzimin maksimal.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues duhet të vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me standardit për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

“Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” - Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara si relatore

(151), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2021 është 17.4 % duke qenë se ishin caktuar 368 çështje në vitin 2021.

Referuar Metodologjisë kjo përqindje pikëzohet me 2 pikë.

Referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar për gjyqtarin e gjykatës së dhomës civile.

Në rastin konkret rezulton që gjyqtarja ka gjykuar më shumë se standardi minimal i punës me vetëm 11 çështje, pasi gjyqtarja gjatë vitit 2021 ka përfunduar 151 çështje si relatores, nga 140 çështje të përcaktuara si standard minimal sasior sipas pikës 3, germa “k” të Aneksit 1 të Vlerësimit, në kushtet kur për një periudhë 6-mujore ajo ka ushtruar detyrën e kryetares së gjykatës. Duhet përmendur fakti që thuhet se 2 muaj gjyqtarja ka qenë me raport mjekësor apo leje vjetore si dhe deri në fund të muajit prill ka qenë e angazhuar me procesin e rivlerësimit kalimtar.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2021, 151 çështje si relatores, (nga të cilat 127 çështje janë me palë kundërshtare), pra duke mos e tejkaluar më shumë se 50% treguesin sasior në fuqi sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, por nga ana tjetër duke pasur parasysh edhe ngarkesën e saj si anëtare (ka përfunduar 199 çështje në këtë cilësi) rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtarja, pavarësisht se rezulton të jetë 17.3%, vlerësohet të pikëzohet me një nivel të ndryshëm nga ai përket përqindjes së pikëzimit referuar metodologjisë, pasi shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarës lidhen me organizmin e gjykatës në trupa gjyqësore me tre dhe pesë gjyqtarë dhe problematikave të lindura për shkak të largimit të gjyqtarëve nga procesi i vettingut,

pamundësisë së gjyqtares për t'u paraqitur në punë për arsye shëndetësore, angazhimin e saj në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet duke e pikëzuar me 6 pikë, nga 87%-93%.

“Koha mesatare e arsytimit të vendimit” - Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7-ditor është si më poshtë:

Në kategorinë “Çështje me palë kundërshtare” është më e gjatë se 7 ditë.

Në kategorinë “Çështje pa palë kundërshtare” prapë më e gjatë.

Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune” koha mesatare e arsytimit të vendimit është 9.4 ditë, pra më e gjatë.

Në kategorinë e çështjeve “Juridiksion fillestar” është 15.7 ditë, pra më e gjatë.

Nga ana tjetër, afati 7-ditor i arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar i përcaktuar në nenin 55 është shumë më i shkurtër krahasuar me afatin 20-ditor.

Referuar shkresës së ardhur nga Gjykata Administrative e Apelit, konkretisht Shkresa nr. 54 Prot, datë 26.01.2022, protokolluar në KLGJ me nr. 146/1 prot, datë 27.01.2022, ku tregohet data e depozitimit të vendimit në sekretari nga gjyqtarja, rezulton që vendimi është depozituar në afat, por ka mbetur për firmën e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues apo për shkak se gjyqtarja ka qenë me raport. Pas rillogaritjes së kohës mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore referuar të dhënave të ardhura me shkresë nga gjykata rezulton si më poshtë:

Në kategorinë “Çështje me palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është rreth 6.6 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural prej 7 ditësh.

Në kategorinë “Çështje pa palë kundërshtare” koha mesatare është 7 ditë, pra aq sa afati procedural.

Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune” është 6.3 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural.

Në kategorinë “Juridiksioni fillestar” është 8.3 ditë, pra më e gjatë se afati procedural prej 7 ditësh, duke e tejkaluar afatin me 1 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i



pakonsiderueshëm, e për pasojë do të vlerësohet se është arsyetuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 55.

Për sa më sipër, me këto të dhëna koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor, rezulton më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjithë kategoritë e çështjeve.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve të analizuara.

“Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore” - Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje...” rezulton se nuk ka të dhëna nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, sepse të gjitha çështjet janë gjykuar në dhomë këshillimi. Në këto kushte, do të vlerësohet se numri i seancave është 1 (një). Nëse do i referohemi numrit mesatar të seancave në dhomë këshillimi, shkaqet që kanë çuar në moszhvillimin e tyre në datën e planifikuar, masat e marra nga gjyqtarja për caktimin e një date tjetër të afërt për zhvillimin e seancës në dhomë këshillimi si dhe masat e nevojshme të marra prej saj për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave me efektivitet, vlerësohet se gjyqtarja ka treguar aftësi shumë të larta për këtë tregues.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, në kushtet kur nuk ka të dhëna për numrin e seancave gjyqësore, për sa kohë që të gjitha vendimet e zgjedhura me short janë shqyrtuar në dhomë këshillimi, do të konsiderohet se numri i seancave gjyqësore është 1-3 dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja është e lartë, dhe duhet të vlerësohet me 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale” - Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja jo gjithmonë ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me afate ligjore, por nga ana tjetër, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar

standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në apel administrativ në dhomë këshillimi.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 20 pikë.

“Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen” - Nga burimet e vlerësimit, renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen lehtësisht.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” - Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata në përputhje me veprimet procedurale të kryera prej saj.

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve, etj.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e dytë “Aftësitë organizative të gjyqtares”, 90 pikë, vlerësimi Shkëlqyeshëm.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

“Etika në punë”

Për të vlerësuar këtë kriter janë analizuar burimet e vlerësimit të marra nga ILD-ja, konkretisht për ankesat. Janë 10 ankesa

Ankesat e paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit, të cilat janë trajtuar nga ILD, nuk rezultojnë të kenë evidentuar elementë të cenimit të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Referuar sa më sipër, pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit se angazhimi i saj është “shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

“Integriteti i gjyqtares” - Është marrë raporti i ILDKPI-së në të cilin konkludohet se a) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklaram të rremë; e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale. Shkalla e aftësia është “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 40 pikë.

#### Paanësia e gjyqtares

“Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese” - Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Edhe për këtë tregues vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 10 pikë.

Për sa i përket “Numri i kërkesave të pranura të palëve për përjashtim”, edhe për këtë tregues është konsideruar i pakonsiderueshëm prandaj duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Propozimi për kriterin e vlerësimit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

#### Për sa i përket kriterit të katërt “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”-

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Për këtë arsye aftësia e saj është propozuar shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Respektimi i konfidencialitetit, edhe për këtë tregues, duke qenë se nuk ka të dhëna për mungesën e mosrespektimit të konfidencialitetit, vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### “Aftësia për të bashkëpunuar”

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe

bashkëpunimit me ta dhe për këtë tregues është vlerësuar aftësia shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën edhe për këtë kriter është vlerësuar maksimalisht duke qenë se ka mungesë të dhënash të ndryshme për ta pikëzuar në një nivel më të ulët, duke e pikëzuar kështu me 10 pikë.

Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

“Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale” - Referuar të dhënave të formularit të integruar të vlerësimit, lidhur me trajnimet që janë paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe aktet e tjera që janë paraqitur nga ana e gjyqtarës, rezulton se gjyqtarja të ketë marrë pjesë në telekonferencën ndërkombëtare të organizuar nga “Antitrust Laë Spring Meeting”, në 23-26 mars, konferencë në përfundim të së cilës gjyqtarja është vlerësuar. Gjithashtu evidentohet se gjyqtarja ka marrë pjesë edhe në Konferencën Ndërkombëtare në “Shkencat Sociale dhe Natyrore” të zhvilluar në Lisbonë. Gjyqtarja ka marrë pjesë në 5 ditë trainimi gjithsej.

Referuar sa më sipër, duke qenë se ka marrë pjesë në 2 aktivitete të zhvilluara për 5 ditë trajnimi vlerësohet të pikëzohet me 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët” – nuk rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në cilësinë e lehtësueses apo ekspertes, për këtë arsye, referuar metodologjisë është pikëzuar me 3 pikë.

“Pjesëmarrja e gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale” – Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë si lektore në Universitetin e Tiranës referuar vërtetimeve të paraqitura nga ana e saj, lektore në Universitetin e Drejtësisë në programin “Bachelor” përsëri në Universitetin e Tiranës; lektore pranë Tirana Business University, edhe këtu për disa leksione; është pjesëmarrëse në konferenca etj. Gjithashtu gjyqtarja ka paraqitur disa vërtetime por që nuk i përkasin periudhës së vlerësimit.

Referuar publikimeve, gjyqtarja ka paraqitur disa publikime, por vetëm njëri i përket periudhës së vlerësimit. Për këtë arsye propozohet pikëzimi i saj me 5 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit është “Shkëlqyeshëm” për treguesin e katërt me 98 pikë.

Propozimi përfundimtar për nivelin e vlerësimit është:

“Aftësitë profesionale të gjyqtarës” 100 pikë.

“Aftësitë organizative” 90 pikë.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” 100 pikë.

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” 98 pikë.

Vlerësimi i përgjithshëm 388 pikë, vlerësuar “Shkëlqyeshëm”.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

*Alban Toro:* Po, kam unë.

Atëherë, unë do të kisha një propozim për ngritje pikësh në nivelin e katër pikëve për “2Aç Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore”. Fillimisht do më duhet të jap një opinion pse e kërkoj këtë dhe natyrisht dhe një nocion të këtij nëngrupi dhe faktorëve që ndikojnë në tek saktësia e saj.

Rendimenti i përfundimit të çështjeve është raporti i numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve gjyqësore që janë caktuar brenda një viti kalendarik dhe natyrisht si burim vlerësimi do të shërbejnë të dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga gjyqtarja dhe mendimi i kryetarit. Të gjithë të dhënat statistikore analizohen gjithmonë në përputhje me situatën, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, dhe këtu ka lindur edhe opinionin im për të kërkuar ngritjen e pikëve, analiza e të cilës të con në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës, deri në pikëzimin maksimal nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli. Kështu që në lidhje me këtë kriter vlerësoj se duhet mbajtur parasysh fakti se gjyqtari për periudhën e vlerësimit ka gjykuar me cilësinë e relatorit por edhe të anëtarit (në total 199 çështje me 3 dhe 5 gjyqtarë), shkaqe që në opinionin tim ndikojnë në rendimentin e gjyqtarit. Po ashtu duhet pasur parasysh që ka ushtruar edhe detyrën e kryetares së Gjykatës Administrative të Apelit, e cila për shkak të funksionit ka 50% të ngarkesës në bazë të nenit 37 të ligjit 98/2016

dhe pothuajse për 3 muaj radhazi ka pasur 2 muaj raport për paaftësi, 10 ditë leje vjetore të pakryer, për të mos thënë procesin e vlerësimit kalimtar i cili për pasojë sjell numrin e çështjeve që ajo duhet të gjykonte brenda kësaj periudhe, për shkak edhe të gjendjes emocionale optimiste që të shoqëron ky proces. Gjithashtu duhet pasur parasysh edhe fakti që gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021 janë pezulluar dhe shkarkuar me vendim të KPK-së dhe KPA-së edhe dy gjyqtarët të cilët kanë qenë në trup gjykues me gjyqtaren {...}, rrethana të cilat kanë ndikuar në moszhvillimit në kohë të gjykimit të planifikuar apo në pamundësi të planifikimit të çështjeve të tjera pas shqyrtimit të anëtarëve të tjerë të trupit gjykues për shkak të ngarkesës së tyre por edhe të numrit të kufizuar të kësaj trupe gjyqësore.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, duke vlerësuar në tërësinë e tyre si dhe të dhënat statistikore në të cilat rezulton se gjyqtarja përgjatë vitit 2021 ka gjykuar 151 çështje si relatorë dhe 199 çështje në cilësinë e anëtarit të trupës gjykuese, pra dukshëm duke tejkaluar më shumë se 50% treguesin sasior në fuqi sipas kriterëve matëse të veprimtarisë gjyqësore, të miratuar me vendimin nr. 261/2, 14.04.2010.

Kështu që në këtë kuadër vlerësoj të pikëzohet me 10 pikë, nga 6 që është pikëzuar në projektraportin e vënë në dispozicion, pasi shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarës lidhen me organizimin e gjykatës me trupa gjyqësore me 3 dhe 5 dhe problematikat e lindura për shkak të largimit të gjyqtarëve nga procesi i vetingut, në pamundësi të gjyqtarës për t'u paraqitur në punë për arsye shëndetësore për një kohë relativisht të gjatë, si dhe angazhimin e saj në procesin e rivlerësimit kalimtar.

***Naureda Llagami:*** Po, zonja Plaku!

***Irena Plaku:*** Atëherë, për sqarim për sa i përket rendimentit. Rendimenti llogaritet vetëm për çështjet civile që i caktohen si relator dhe jo si anëtar i trupit gjykues. Duke qenë se të gjitha ato shkaqe janë cituar të raportin e vlerësimit, shkaqet që lidhen me faktin e qenies së saj me raport shëndetësor, ngarkesën apo angazhimin në procesin e rivlerësimit, janë analizuar duke e rritur me dy nivele. Kështu që për mua është e

mjaftueshme sepse nuk llogariten 199 çështje të cilat ajo i ka gjykuar si anëtare, por vetëm çështjet e caktuara si relatores. Edhe si ngarkesë, si relatores, thashë që ka kaluar standardin vetëm me 11 çështje dhe jo më shumë. Janë analizuar të gjitha ato rrethana që ju i thatë, por duke e pikëzuar me një nivel me dy pikë. Po them që nuk është mbi 50% referuar standardit sepse për të përcaktuar standardet përcaktohen çështjet të cilat janë si relatores, jo çështjet si anëtare e trupit gjykues. Kjo ishte për sqarim.

**Naureda Llagami:** E hedhim në votim.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Kundër.

**Alban Toro:** Pro.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Yllka Rupa:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord. (ripërtëritje e votës.)

*(Miratohet propozimi i zotit Toro.)*

**Naureda Llagami:** Kalojmë në miratimin në tërësi të projektraportit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord, duke qenë se u votua nga shumica pikëzimi i ndryshëm.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

Nëse mundem të shpreh një opinion tani apo mbasi të mbarojë votimi? Ta them në vijim.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...} për vitin 2021”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Dritan Hallunaj:** Mundem?

Atëherë, pas përfundimit të votimit dhe daljes me vendim unë dua të bëj një koment për sa i përket pjesës së votimit të sotëm, për arsyet që do t’i them si më poshtë.

Në radhë të parë ndihem mirë me veten time se është i njëjti standard që kam mbajtur dhe herën e parë kur u diskutua për një kandidate A.N. (se ky është rasti i dytë) dhe jam shumë komod sinqerisht me veten time pasi propozimet e mia nga ana e shumicës, herën e kaluar, u rrëzuan. Ndërsa sot ne kemi propozuar dhe kemi pranuar rritjen e asaj që unë kam propozuar herën tjetër. Thjesht rrimë tek standardi, pra çfarë standardi po mbajmë, se e kemi merak këtë pjesën e standardit. Pse them këtë?



E them këtë se duke filluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtares”, “Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë”, “Respektimi i afateve ligjore”, që gjyqtarja është vlerësuar me 9 pikë, ndërsa gjyqtarja tjetër po me 9 pikë. Sa i përket “Plotësimin të standardeve minimale kohore” shohim që gjyqtarja sot kemi miratuar 5 pikë, ndërsa për gjyqtaren A.N. e kemi vlerësuar me 4 pikë (pra ne KLGJ-ja të gjithë me shumicë). Po të vlerësojmë raportet e të dyjave, t’i marrim të dyja raportet, ën raportin e A.N. ne themi që nga tërësia rezulton që ka gjykuar 80 çështje në një afat dhe 74 çështje me afat standardi minimal. Shkurtimisht po kaloj në fund. Pra ka përfunduar jashtë afatit 91% të çështjeve. Ndërsa sot, në raportin e sotëm thotë që ka gjykuar tej afatit 95% të çështjeve jashtë afatit. Në këtë kuadër, në konkluzionin përkatës, duke bërë edhe ngarkesën e gjyqtares si relatores dhe si anëtare, që në rastin konkret ngarkesa e gjyqtares që kemi pasur herën tjetër, 154 vendime si relatores dhe 296 si anëtare, ndërsa sot jemi 151 dhe 199. Kam përshtypjen matematika thjesht lejon të kuptosh që është numri më i vogël sesa.... dhe në fund vlerësohet me 5 pikë, ndërsa këtë tjetrën me numër më të vogël, përqindje më të ulët të çështjeve tej afatit, vlerësohet me 4 pikë.

Po të vijojmë me çështjet e tjera që kanë të bëjnë me plotësimin e standardeve minimale kohore, i marrim një nga një, pa ju humbur kohë, 13 çështje me palë kundërshtare, 2 çështje marrëdhënie pune, 4 me juridiksion fillestar dhe në përfundim arrihet që 22.9% e çështjeve janë në tejkalim të standardit minimal kohor (*flitet për gjyqtaren tjetër*). Dhe me këtë që thashë, me 22.9% ne e vlerësojmë me 4 pikë. Me të njëjtin standard, po ne sot, 18 çështje me palë kundërshtare, 4 çështje marrëdhënie pune, 4 çështje juridiksion fillestar, dhe në fund është sipas metodologjisë që ne kemi miratuar, 37% e çështjeve në tejkalim të afatit të standardit minimal kohor, pra 37 me 22.9, dhe ne këtu kemi vlerësuar sot me 5 pikë.

Ka dhe çështje të tjera, problematika të tjera. Thjesht unë doja të thosha që jam shumë i lumtur që mendimi që shfaqta atë ditë, propozimet që u shfaqën atëherë, që nuk u morën parasysh, janë marrë sot parasysh dhe janë pasqyruar në raport si dhe kemi ruajtur të njëjtin standard.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, duke qenë se zoti Hallunaj na bëri një krahasim midis dy vendimmarrjeve të Këshillit, që në vlerësimin tim është e tepërt dhe jo e duhur, i kujtoj zotit Hallunaj që për të ruajtur standardin, mundet që sot të kishte propozuar ulje pike, për të barazuar 5 me 4 apo 4 me 5. Problemi është që puna e gjyqtarit nuk është shifra. Janë vërtet ato shifra, por në projektraport, të cilin unë e kam mbështetur, ka një sërë faktorësh që janë marrë parasysh në vlerësimin e gjyqtarës aktuale, që kanë çuar në një pikëzim, faktorë të cilët nuk ishin prezent në gjyqtaren e parë që kishim vlerësuar. Vlerësimi i gjyqtarit nuk është vetëm analizë të dhënash statistikore, është edhe analizë logjike e të dhënave statistikore. Puna e gjyqtarit nuk është e standardizuar. Vlerësohet gjyqtari sipas punës individuale që ka. Referuar faktorëve që relatorja ka specifikuar në të gjithë treguesit e “Aftësive organizative” që lidhen me raportet mjekësore, situatën e vetingut, situatën e Covid-it ku ka qenë një kohë e gjatë, pezullimin e veprimtarisë gjyqësore, shkarkimin e gjyqtarëve të trupit të saj gjykues, jo të trupave gjykues të tjerë; faktin që ajo për 6 muaj e gjysmë ka ushtruar edhe detyrën e zëvendëskryetarit, ka pasur një standard më të lartë sesa gjyqtarja e mëparshme që kishim vlerësuar. Për të gjitha këto arsye, edhe për të njëjtën gjyqtare unë mendoj që pikëzimi nga ana e relatores tashmë është miratuar nga Këshilli, nuk ndryshon standardin sepse standardi nuk është thjesht krahasim shifrash. Faleminderit!

**Dritan Hallunaj:** Atëherë, sa për ta mbyllur, shkurtimisht.

Nuk kam arsye unë që të kërkoj uljen e pikëve sot pasi këtë mendim e kam pasur edhe përpara, pra unë këtë qëndrim kam mbajtur, që duhet vlerësuar në këtë mënyrë. Ndërsa të gjithë bashkë pastaj t'i shohim të dy në të njëjtën mënyrë, me të njëjtën njësi matëse. Kjo ishte. Pra unë jam shumë dakord, bile mbështeta edhe kolegun Toro që propozoi rritjen e disa pikëve, se ky ka qenë qëndrimi që unë kam mbajtur dhe jam plotësisht dakord për këtë pjesë. Faleminderit!

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

34



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 06.04.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

- 4.1 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;
- 4.2 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë;
- 4.3 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje;
- 4.4 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
- 4.5 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini;
- 4.6 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
- 4.7 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;
- 4.8 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë;
- 4.9 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)

35

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 06.04.2023***

- |                           |                  |
|---------------------------|------------------|
| 3. <i>Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i>     | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |
| 6. <i>Ridvan Hado</i>     | <i>(anëtar)</i>  |
| 7. <i>Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>  |
| 8. <i>Marçela Shehu</i>   | <i>(anëtare)</i> |
| 9. <i>Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Yllka Rupa</i>     | <i>(anëtare)</i> |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**
4. **Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
5. **Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
6. **Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
7. **Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
9. **Edmon Hoxhaj, (Birn).**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:
  - 4.1 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;

- 4.2 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë;
- 4.3 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje;
- 4.4 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
- 4.5 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;
- 4.6 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
- 4.7 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;
- 4.8 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë;
- 4.9 Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja e fundit e rendit të ditës që ka të bëjë me krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të gjykatave respektive.

Fillojmë me gjykatën Mat, gjykata Kavajë, gjykata Lushnje, gjykata Përmet, gjykata Kurbin, gjykata Pogradec, gjykata Tropojë, Pukë dhe Krujë.

Kush do relatojë?

Kryetari nga grupi i hartës.

*Ilir Rusi:* Faleminderit Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim të miratimit të akteve në lidhje me funksionimin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të riorganizuara, paraqesim këto projekt-akte në lidhje me ngritjen e Komisioneve të Ristrukturimit të gjykatave respektive.

Për sa i përket seksionit të detyrimeve ligjore për nxjerrjen e aktit, janë të njëjta siç kur kemi miratuar edhe kohë më parë.

Për sa i përket natyrës së aktit dhe harmonizimit të tij, ndryshimi është se Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm do fillojnë të funksionojnë në datën 1 maj 2023.

Ky objektivi merr rëndësi të veçantë në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, me qëllim shqyrtimin dhe sistemimin e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Pogradec, Tropojë, Kurbin, Pukë, Krujë, që riorganizohen, pasi gjykatat pritëse, Gjykata e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier,

Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë duhet të kenë kapacitetet e nevojshme profesionale për të vijuar ofrimin e shërbimeve në kohën e duhur dhe me cilësi.

Në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komisioneve të Ristrukturimit jemi bazuar në vendimin nr. 557, i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në 29 dhjetor të 2022. Një veçanti ka që përbërja e Komisionit të Ristrukturimit në disa gjykata, konkretisht gjykata Mat, Krujë dhe Kavajë përbëhet nga kryetarët, ndërsa gjykatat e tjera përbëhet nga zëvendëskryetarët. Në lidhje me gjykatat Pogradec, Kurbin, Kukës, Shkodër dhe Dibër, funksionet e kancelarit ushtrohen nga nëpunësi i caktuar për kryerjen e detyrave të kancelarit. Ndërsa në gjykatat e tjera do të përbëhen nga vetë kancelarët përkatës.

Ajo që vlen të theksohet është fakti që në rastet e ankesave të nëpunësve/punonjësve, Komisionet e Ristrukturimit do të marrin në konsideratë edhe pozicionet e së njëjtës kategori, bazuar në listën e pozicioneve vakante të vëna në dispozicion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, vetëm të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Procesi i riorganizimit të gjykatave kërkon para së gjithash që të ruhet kapaciteti profesional aktual i gjykatave, si e vetmja mënyrë për të siguruar ofrimin e shërbimeve cilësore.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është duke marrë të gjitha masat e nevojshme për të koordinuar procesin, me qëllim që çdo nëpunës civil gjyqësor ashtu dhe punonjës të tjerë të sistemohen në pozicionet përkatëse.

Akti i propozuar do të zbatohet nga anëtarët e Komisioneve të Ristrukturimit, kryetarë/zëvendëskryetarë dhe kancelarë apo nëpunësit e caktuar për kryerjen e detyrave të kancelarit të gjykatave. Konkretisht ato janë hartuar në frymën edhe të akteve të mëparshme të hartuara në lidhje me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe tashmë është një praktikë për herë të dytë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me funksionimin e Komisioneve të Ristrukturimit dhe do funksionojë: në lidhje me strukturimin e Gjykatës së Tropojës, pranë Gjykatës Kukës; Gjykatës së Pukës, pranë Gjykatës Shkodër; Gjykatës së Matit, pranë Gjykatës Dibër; Gjykatës së Kurbin, pranë Gjykatës Pogradec.

pranë Gjykatës Lezhë; Gjykatës së Krujës, pranë Gjykatës Tiranë; Gjykatës Kavajë, pranë Gjykatës Durrës; Gjykatës Lushnje, pranë Gjykatës Fier; Gjykatës Pogradec, pranë Gjykatës Korçë dhe Gjykatës Përmet, pranë Gjykatës Gjirokastrë.

Ajo çfarë duhet ne të përcaktojmë në këtë plenare, përveç miratimit të aktit në përmbajtje, në lidhje me kompetencën dhe funksionimin e saj, duhet të miratojmë përbërjen e Komisioneve të Ristrukturimit në lidhje me përfaqësimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në këto Komisione Ristrukturimi.

Në praktikën e mëparshme është përfaqësuar nga një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor i cili ka koïnciduar të jetë edhe anëtar i grupit të hartës. Në raport me faktin aktual.. edhe për shkak se veprojnë në gjykata të ndryshme nga njëra-tjetra, kështu që është në vlerësim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të përcaktuar nivelin e përfaqësimit në Komisionet e Ristrukturimit.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit!

Atëherë, ndonjë propozim si do e bëjmë përfaqësimin?

Atëherë, për të bërë një ndarje më të mirë të punës... (ndërpritet audio).

Atëherë, për të vijuar me propozimet, nga Grupi i Punës, kë sugjeroni, kush është anëtar që do të angazhohet në këto komisione, përveç anëtarëve, (unë sugjeroj që dy anëtarët që kanë qenë tek grupi i punës, patjetër duhet të angazhohen), ndonjë anëtar tjetër që kërkon të angazhohet?

***Alban Toro:*** Edhe unë.

***Naureda Llagami:*** Po, edhe zoti Toro shpreh vullnetarisht për t'u angazhuar.

Duke qenë se kemi të gjithë këto komisione, fillojmë me Matin. Nga Grupi i Punës, Ilir?

Atëherë, Ilir Rusi do jetë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Kush nga anëtarët? Marçela! Marçela Shehu do jetë kryetare e komisionit.

Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Kush ofrohet? Z. Toro do jetë kryetar i komisionit, përfaqësues i KLGJ-së.

Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Sërish propozohet z. Toro të jetë kryetar i këtij komisioni.

Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Zonja Shehu vetë propozohet për të qenë kryetare e komisionit, përfaqësuesja e KLGJ-së.

Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Zoti Toro vetë propozohet për të qenë kryetari i komisionit si përfaqësues i KLGJ-së.

Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Zoti Rusi vetë propozohet si kryetar i komisionit, përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Sërish zoti Rusi vetë propozohet si kryetar, përfaqësues i KLGJ-së në këtë komision.

Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Vetë propozohet zonja Shehu kryetare, përfaqësuese e KLGJ-së.

Me kaq, këto ishin propozimet.

Kalojmë në grup të gjithë ngritjen e këtyre komisioneve, ku detyra e Këshillit ishte vetëm për të përcaktuar përfaqësuesin që do të drejtojë këto komisione.

Pra komisioni i parë është për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat. Sipas propozimit të Grupit të Punës, me përfaqësues z. Rusi. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.



*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ku kryetare e këtij komisioni si përfaqësues e KLGJ-së është zonja Shehu. Jemi dakord?

*Ilir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, ku zoti Toro do jetë kryetar, përfaqësues i KLGJ-së.

*Ilir Rusi*: Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Nuk dëgjohej vota.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, akt i cili vjen sipas propozimit të Grupit të Punës. Kryetar dhe përfaqësues i KLGJ-së do të jetë zoti Toro. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ku kryetare në cilësinë e përfaqësueses së KLGJ-së është zonja Shehu. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në propozimin tjetër për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku kryetar është zoti Toro si përfaqësues i KLGJ-së. Jeni dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, ku kryetar propozohet zoti Rusi, përfaqësues i KLGJ-së. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** nuk dëgjohet vota.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Pukë, me përbërjen që propozohet nga Grupi i Punës, ku si kryetar, përfaqësues i KLGJ-së është zoti Rusi. Jemi dakord?

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek akti i fundit, krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me përbërje sipas propozimit të bërë nga Grupi i Punës, ku përfaqësues i Këshillit, në cilësinë e kryetarit, do të jetë zonja Marçela Shehu. Jemi dakord?

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, me kaq po mbyllim mbledhjen e sotshme.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**